



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2024

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.336, DATË 31.05.2006 "PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në Vendimin nr.336, datë 31.05.2006 e Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.60, datë 1.2.2006 e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror", bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 1, të Vendimit, togfjalëshi "Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç" zëvendësohet nga togfjalëshi "Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes".
2. Ngarkohen Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**